



KOMUNIKATË

14. 09. 2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e vetë të 29-të të rregullt, shqyrtoi pikat e rendit të ditës me theks të veçantë, detyrat që dalin nga procesi i organizimit të zgjedhjeve të 15 nëntorit. Në fillim të mbledhjes kryetarja e KQZ-së, Nesrin Lushta, i ftoi anëtarët e KQZ-së dhe të tjerët që të japin maksimumin e tyre në ditët e ardhshme në procesin e organizimit të zgjedhjeve. Anëtarët e KQZ, në fillim të debatit u pajtuan që propozimi për shqyrtimin e Rregullorës së Punës të shqyrtohet në një takim të veçantë të KQZ-së. KQZ, në vazhdim të takimit aprovoi rendin e ditës, si dhe miratoi raportet 27-të dhe 28-të nga mbledhjet e kaluara. Kryetarja Nesrin Lushta, i njoftoi anëtarët e KQZ-së lidhur me takimin me Ambasadën Gjermane, e cila ka shprehur dëshirën të ndihmojë në Qendrën Mediale dhe, votuesit e vërbër si dhe për takimin me KFORI-in, lidhur me çështjet e sigurisë për zgjedhjet. Kryetarja Nesrin Lushta, tha gjithashtu se nesër më 15 shtator, përfundojn afatet ligjore që kanë të bëjnë me Regjistrimin e Votuesëve jashtë Kosovës, të Shërbimit të Votuesëve, si dhe aplikimi i subjekteve politike për Çertifikim.

Kryeshefi i SKQZ-së, Xhemajl Peqani, e njoftoi me shkrim KQZ-në lidhur me aktivitetet e Sekretariatit. Në këtë drejtim, u diskutua për mbajtjen e zgjedhjeve në tërë teritorin e vendit, pastaj lidhur me Shërbimin Votues, por edhe me aspektet e Informimit Publik. Në takimin e sotshëm Zyra për Regjistrimin e Partive Politike, i rekomandoi KQZ-së t'i certifikoj dy inisiativa qytetare dhe dy kandidatë të pavarur, pasi që kanë plotësuar kushtet e kërkuara me ligj. KQZ, e bëri certifikimin e Inisiativës Qytetare Gizor nga

Ranillugu, Gizap nga Kamenica, si dhe certifikoi kandidatët e pavarur Mexhit Foniqin dhe Nevzat Hydaverdin, për Këshilltar të Kuvendit Komunal të Prishtinës.

Anëtarët e KQZ-së, u njoftuan edhe me punën e Këshillave të KQZ-së. Lidhur me punën e këshillave, referuan z. Xhelil Pajaziti, kryetar i Këshillit për Buxhet dhe Prokurim dhe Ilir Fetahu, kryetar i Këshillit për Operacione Zgjedhore. KQZ, ndër të shqyrtoi Draft-Vendimin e pagesave dhe mënyrën e pagesave për anëtarët e KVV-e, miratoi rekomandimet për përcaktimin e numrit të votuesëve për një vendvotim, si dhe u përcaktua afati që subjektet politike t'i nominojnë anëtarët e KVV-e. KQZ, përcaktoi që afati për nominim i anëtarëve të KVV-e, të bëhet prej 17- 21 shtator.